



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE  
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

**RAPORT PUNE PER VITIN 2007  
(periudha raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2007)**

**SEKSIONI I FINANCAVE DHE TARIFAVE NE ZRRUM**

**Prishtinë, 15 janar 2007**

1. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin Janar 2007

Numri Ren.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
1.1.	Angazhimi rreth rregullimit të dokumentacionit të vitit 2006.	Gjatë ditëve të para të janarit stafi i këtij seksioni ka qenë i angazhuar në rregullimin, sistemimin dhe fjalimin e gjithë dokumenteve në të cilat është punuar gjatë vitit 2006.	Ramiz Kokollari dhe Sami Hasani
1.2	Mbajtja e sesioneve konsultative me KRU-ët për përgatitje e aplikimit për tarifa shërbimi.	Nga fillimi i gjysmës së dytë të muajt janar '07 kemi qenë të angazhuar në mbajtjen e takimeve konsultative me të gjitha KRU-të për përgatitjen dhe sqarimin e softuerit të modelit tariforë për këtë vit. Workshopi për këtë çështje është mbajtur me 17 janar 2007.	
1.3	Raportit i Përgjithshëm Përfundimtarë i Kompanive	Krahas shqyrtimit të softuerit të modelit tariforë në çdo takim kemi kërkuar dhe këmbëngulur në përgatitjen dhe dorëzimin e Raporteve Përfundimtare të Përgjithshëm të Kompanive (RPPK), për çka shumë herë nuk kemi gjetur përkrahjen dhe gatishmërinë e kompanive për këtë synim tonin.	
1.4	Bashkëpunimi me konsultantet e IPA-së të kontraktuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim për asistencë në ZRRUM.	Paralelisht me kryerjen e punëve tona të përditshme kemi qenë të angazhuar në takime pune me konsultantet e zyrës sonë për kryerjen e punëve të cilat i kanë takua seksionit të financave dhe tarifave si dhe rreth RPPK-ës.	
1.5	Amandamenti i disa pjesëve të Rregullës Tarifore ZRRUM –R02/U&UK	Gjatë amandamentimit të disa pjesëve të Rregullës Tarifore ZRRUM-R02/U&UK, stafi i këtij seksioni ka marrë pjesë aktive gjatë përpilimit të tyre dhe konkludimit të tyre.	
1.6	Kërkesë së KRM "Pastrimi" Prishtinë për korrigjim të tarifave të mbeturinave.	Pas pranimit të kërkesës së "Pastrimit" jemi angazhuar sistematikisht gjatë janarit në vlerësimin e kësaj kërkesë duke mbajtur takime të rregullta me stafin e KRM-ës për sqarim të kërkesës së tillë të parashtruar zyrtarisht me 31 dhjetor 2006.	
1.7	Vlerësimi i kërkesës së KRU "Bifurkacioni" Ferizaj për përcaktim të tarifave të zonave rurale.	Stafi i këtij seksioni ka pasur në shqyrtim nga fundi i vitit 2006 kërkesën e "Bifurkacionit" për përcaktim të tarifave për katër zona rurale me të cilat është marrë intensivisht kohë pas kohe.	

## 2. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin Shkurt 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
2.1.	Korrigjimi i tarifave të mbeturinave për KRM "Pastrimi" Prishtinë.	Edhe gjatë këtij muaj kanë vazhdua kontaktet dhe takimet intensive me përfaqësuesit "Pastrimit" për vlerësim të arsyshmerisë së tyre për përcaktim të tarifës.	Ramiz Kokollari dhe Sami Hasani
2.2	Përcaktimi i tarifave për katër zona rurale, sipas kërkesës së KUR "Bifurkacioni" Ferizaj.	Jemi angazhuar në diskutim, vlerësim dhe sqarimin të dhënave të ofruar nga kjo kompania për përcaktim të tarifave të shërbimit për zonat rurale të Ferizajt.	
2.3	Kontaktet me KRU-ët për procesin tariforë dhe fillimin e aplikimit për tarifa shërbimi për vitin 2007/08.	Është bërë ftesë zyrtare KUR-ve për fillimin e procesit të tarifimit për vitin 2007/08 dhe në vazhden e kësaj pune seksion ka mbajtur kontaktet të rregullat me kompanitë e ujit duke prit aplikacionit para 1 marsi 2007.	
2.4	Bashkëpunimi me konsulentet e IPA-së për proceset në vijim.	Edhe gjatë këtij muaj ka vazhdua bashkëpunimi dhe kontaktet me konsulentet e zyrës.	
2.5	Fillimi i kontakteve me KLMC-ën për procesin e përgatitjeve të aplikimit për tarifa e vitit 2007.	Me përfaqësuesit e KLMC-ës kemi mbajtur takim për inicimin e procedurave të aplikimit për tarifa shërbimi, kryesisht për çështjet që kanë të bëjnë me asetet dhe investimet kapitale.	
2.6	Vazhdimi i angazhimit në marrjen e Raportit të Përgjithshëm të KRU-ve dhe KRM-ëve për vitin 2006	Seksioni i tarifave ka insistuar nga kompanitë që të përgatisin dhe raportojnë të dhënat për Raportin Përfundimtarë Vjetorë (RPV).	

### 3. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin Mars 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
3.1.	Kërkesë së KRM "Pastrimi" Prishtinë për korrigjim të tarifave të mbeturinave.	Edhe gjatë muajt mars '07 jemi marrë intenzivisht me kërkesën e "Pastrimit" për vlerësim të arsyeshmërisë së saj dhe gjetjen e kriterëve ekuilibruese për përcaktim të një tarife të balancuar duke analizuar dhe komentuar të dhënat e prezantuar.	Sami Hasani
3.2	Përcaktimi i tarifës për katër zona rurale nën menaxhimin e KRU "Bifurkacioni" Ferizaj.	Me 19 mars 2007 ZRRUM-i ka përcaktua tarifën për katër zona rurale të shërbimit të financuar nga SDC-ja Zvicëranë e cila i ka ofrua për menaxhim KRU "Bifurkacionit" Ferizaj.	
3.3	Kontaktet me KRU-ët dhe "Ibër-Lepencin" për procesin tariforë dhe fillimin e aplikimit për tarifa shërbimi për vitin 2007/08.	Në vazhdim të angazhimeve të veta ky seksion ka mbajtur kontaktet të rregullta me kompanitë e ujit dhe zyrtarisht ka ftua të njëjtat të përgatisin aplikacionin dhe të bëjnë aplikimin për të njëjtat. Për ato kompani që kanë aplikua me kohë kemi konfirmuar pranimin dhe vlerësuar kompletueshmërinë e dokumentacionit.	
3.4	Bashkëpunimi me konsulentet e IPA-së për proceset në vijim.	Edhe gjatë këtij muaji ka vazhduar bashkëpunimi dhe kontaktet me konsulentet e kësaj zyre për procesin tariforë 2007/08 të KLMC-ës.	
3.5	Fillimi i kontakteve me KLMC-ën për procesin e përgatitjeve të aplikimit për tarifa shërbimi për vitin 2007.	Me KLMC-ën kanë vazhduar kontaktet për iniciimin e procedurave të aplikimit për tarifa shërbimi, kryesisht për çështjet që kanë të bëjnë me asetet dhe investimet kapitale.	
2.6	Amandamenti i Rregullës ZRRUM-R02/GM	Me 29 mars 2007 është bërë amandamenti i Rregullës ZRRUM-R02/GM dhe kemi vazhduar përgatitjet për fillimin e përgatitjeve për hapjen e procesit tariforë për KRM-ët.	
1.7	Vazhdimi i angazhimit në marrjen e RPV-ëve nga KRU-ut dhe KRM-ët për vitin 2006	Çështja e RPV-ëve ka ardhë duke u marginalizuar nga proceset tjera, ngarkesa e KRM-ëve dhe për shkak të hulumtimeve për gjetjen e mënyrës së formave tjera më adekuata të raportimit.	

#### 4. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin Prill 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
4.1	Përcaktimi i tarifës së korigjuar të mbeturinave për KRM "Pastrimi" Prishtinë për vitin 2007.	Me 2 prill 2007 ZRRUM-i ka përcaktua tarifën e korigjuar për kategoritë e konsumatorëve shtëpiakë për KRM "Pastrimi" Prishtinë për shkak të fillimit të shfrytëzimit të deponisë publike të financuar nga AER-i dhe të menaxhuar nga KLMC-ja.	Sami Hasani
4.2	Kontaktet me KRU-ët për procesin tariforë për vitin 2007/08.	Gjatë këtij muaj shumica e kompanive kanë bërë aplikimet formale dhe për to kjo zyrë ka përgatitë dhe dërgua të gjitha komentet e veta në formë të konfirmimit të pranimit të aplikacioneve dhe ka vlerësua kompletueshmerinë e tyre nga aspekti formalo- administrativë. Gjatë këtij muaj kemi fillua në shqyrtimin e aplikacioneve të arritura dhe kemi fillua dhe lëshimin e Raportet të Vlerësimit Preliminarë (RVP) për të dhënat e raportuara me komentet për të njëjtat.	
4.3	Bashkëpunimi me konsulentet e IPA-së për proceset në vijim.	Për këtë qëllim ZRRUM-i ka vazhdua mbajtjen e kontakteve shumë të shpeshta dhe intensive me grupin e konstantëve.	
4.4	Fillimi i kontakteve me "Ibër-Lepencin" për procesin e përgatitjeve të aplikimit për tarifa 2007. procedurës për	Pas marrjes së aplikacionit nga NPH "Ibër-Lepenc" Prishtinë, me 19 mars 2007 kemi vazhdua kontaktete intensive për gjetjen e mënyrës ma të përshtatshme për përcaktim të tarifës së ujit me shumicë. Për këtë kompani kemi bërë Vlerësimin Preliminarë dhe kemi kërkuar komentet e saja.	
4.5	Angazhimi rreth procesit tariforë të KLMC-ës.	Me përfaqësuesit e KLMC-ës kemi mbajtur takime të rregullta për formën dhe mënyrën inicimit të procedurave të aplikimit për tarifa shërbimi dhe në to në shumicën e rasteve kanë marr pjesë konsulentët e ZRRUM-it (IPA dhe UNDP).	
4.6	Raporti i Përgjithshëm Përfundimtarë i KRU-ve dhe KRM-ëve për vitin 2006	Çështja e këtij raporti ka fillua të marginalizohet pasi që është suxherua që ky raport është shumë i detaizuar dhe paraqet ngarkesë për kompanitë në stadin e tanishëm të punës.	

## 5. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin Maj 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
5.1	Kontaktet me KRU-ët për procesin tariforë dhe fillimin e aplikimit për tarifa shërbimi për vitin 2007/08.	Gjatë këtij muaj kemi vazhdua punën tonë me kontakte intensive me shumicën e kompanive për dinamizm të procesit për plotësim të dhënave dhe komentim të RPV-ëve tona të dërguara. KRU-të nuk kanë qenë shumë të gatshme për tu përgjigj sfidave dhe procesi po ecte me vështirësi. Prandaj, ZRRUM-i ka humb shumë energji për nxitje efikase të këtij procesi dhe ofrim të përmbylljes së të dhënave të raportuara. Të dhënat në zëra të caktuar kanë qenë jo shumë të bazuar dhe pak të besueshme dhe kanë krijuar vështirësi për vlerësim.	Sami Hasani dhe Gëzim Bullatovci
5.2	Bashkëpunimi me konsulentet e IPA-së për proceset në vijim.	Edhe gjatë këtij muaj ka vazhdua bashkëpunimi dhe kontaktet me konsulentet e zyrës për procesin tariforë 2007/08 të KLMC-ës.	
5.3	Aplikimi i KLMC-ës për procesin e përgatitjeve të aplikimit për tarifa '07.	Nga KLMC-ja kemi marrë aplikacionin e parë për tarifa të këtij viti me 19 maj 2007. Dokumentacionit të tillë kemi fillua ti qasemi për vlerësim të gjithanshëm	
5.4	Kalanderi i fillimit të procesit të aplikimit për tarifa shërbimi për KRM-ët.	Ky seksion ka qenë i angazhuar edhe në përgatitjen e kalendarit për procesin tariforë të KRM-ëve për vitin 2007/08 dhe për këtë qëllim janë ftua të njëjtat të aplikojnë ma së voni deri me 1 qershor 2007.	

## 6. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin qershor 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
6.1	Kontaktet me KRU-ët për procesin tariforë dhe fillimin e aplikimit për tarifa shërbimi për vitin 2007/08.	Edhe gjatë këtij muaj kemi vazhdua punën tonë me kontakte intensive me KRU-të për kompletim, sqarim dhe plotësim të dhënave të ofruara nga kompanitë. Disa kompani kanë tregua një indiferencë të madhe për që arsye kanë vështersua punën e seksionit. KRU "Radoniqi" Gjakovë ka aplikua me katër muaj vonesë dhe ka çrregullua radhën e punës Mangësitë ngadalë ose shumë pak mënjanoheshin.	Sami Hasani dhe Gëzim Bullatovci
6.2	Bashkëpunimi me konsulentet e IPA-së për proceset në vijim.	Edhe gjatë këtij muaj ka vazhdua bashkëpunimi dhe kontaktet me konsulentet e zyrës për procesin tariforë 2007/08 të KLMC-ës.	
6.3	Tarifa për KLMC-ën për procesin për tarifor 2007/08.	ZRRUM-i gjatë këtij muaj ka përcaktua tarifën për KLMC-ën me vlefshmëri nga 1 qershori 2007 e cila ka ardhë si rezultat e të dhënave dhe politikave të caktuara për ngritjen shkallës së inkasimit.	
6.4	Procesi tariforë për KRM-ët për vitin 2007/08	ZRRUM-i ka fillua të marrë aplikacionet e disa kompanive nga 1 qershori dhe në afatin e paraparë ka konfirmua pranimin dhe vlerësua kompletueshmerisë së tyre. Për kompanitë tjera të cilat nuk kanë aplikua akoma kanë vazhdua kontaktet për shtytjen e tyre për aplikim . Njëkohësisht kanë vazhdua kontaktet për sqarim të procesit dhe të dhënave.	

## 7. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin korrik 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
7.1	Procesi tarifor për KRU-ët për vitin 2007/08.	<p>Aktiviteti i jonë gjatë korrikut ka qenë në përmbylljen e procesit tariforë për Raportet Preliminare të Vlerësimit për KRU-të. Për këtë qëllim kemi organizua takimet e fundit me përfaqësuesit e KRU-ve ku janë diskutua dilemat e fundit. Me disa kompani kanë vazhdua kontaktet për sqarimet përfundimtare edhe për një kohë pasi që të gjitha dilemat nuk janë mënjanua. Kjo ka pas të bëjë me "Hidroregjionin-Jugorë" dhe "Radoniqin".</p>	Sami Hasani dhe Gëzim Bullatovci
7.2	Bashkëpunimi me konsulentin e UNDP-ës.	<p>Puna e përcaktimit të tarifave për IL-ët është përgatit në versionin fillestarë e cila ka ardhë si rezultat i përcaktimit të stafit të ZRRUM-it në bashkëpunim me konsultantin e UNDP-së.</p>	
7.3	Procesi tariforë për shërbimet e tarifave të KRM-ëve.	<p>Ka vazhdua puna rreth sqarimit të dhënave dhe komenteve fillestare të dhëna nga ZRRUM-i për aplikacionet e kompanive të cilat i ka raportua ZRRUM-i. Rigrupimi dhe rikategorizimi i shfrytëzuesëve të shërbimeve ka qenë pika ma kritike për definim dhe përcaktim nga kompanitë.</p>	
7.4	Rekrutimi i stafit të ri për Seksionin e tarifave.	<p>Angazhimi rreth përgatitjeve për selektimit të aplikantëve për Seksionin e Tarifave të cilët kanë hy në rrethin e ngushtë.</p>	
7.5.	Tarifa ujit me shumicë të UR Mitrovica, Mitrovicë	<p>ZRRUM-i ka fillua punën edhe për përcaktim të tarifës së ujit me shumicë për URM-ën për herë të parë e cila ka ardhë si kërkesë e qëndrimeve të marra në AKM.</p>	

## 8. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin gusht 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
8.1.	Procesi tarifor për KRU-ët për vitin 2007/08.	<p>Gjatë këtij muaj ky seksion ka qenë i angazhuar në përgatitjen e të dhënave të marra nga kompanitë për përpilimin Raporteve Përfundimtare të Vlerësimit (RPV).</p> <p>Si çështje tjetër kanë mbet shqyrtimi i komenteve të marra nga kompanitë që kishin ofrua opinionet e tyre për gjetjet tona.</p> <p>Me disa kompani kanë vazhdua kontaktet për sqarimet përfundimtare të konstatuara para fillimit të proceseve tjera.</p>	Sami Hasani dhe Gëzim Bullatovci
8.2	Bashkëpunimi me konsulentin e UNDP-ës dhe IPA-së për proceset në vijim.	<p>Angazhimi i jonë ka vazhdua në përpilimin e politikave të reja tarifore me kompanitë që ofrojnë shërbimet e mbeturinave në vend.</p> <p>Puna ka vazhdua po ashtu edhe në definimin e procesit të përcaktimit të tarifave për ujin me shumicë të IL-ës.</p>	
8.3	Procesi tariforë për shërbimet e tarifave të mbeturinave për KRM-ët.	<p>Gjatë këtij muaj është intensifikua puna rreth raporteve të para dhe të dyta të vlerësimit të aplikacioneve të kompanive të cilat kanë arrit në ZRRUM.</p> <p>Rigrupimi dhe rikategorizimi i shfrytëzuesve të shërbimeve sipas propozimit të kompanive dhe të miratuara nga ZRRUM-i ka has në vështirësi gjatë zbatimit.</p> <p>ZRRUM-i është angazhua maksimalisht për përcaktim të saktë dhe pa vonesa.</p>	
8.4	Rekrutimi i stafit të ri për Seksionin e tarifave	<p>Një angazhim shtesë kemi pas për përgatitjen e rekrutimit të stafit të ri në këtë sektor i cili ka marrë një pjesë të konsiderueshme të kohës.</p> <p>Seksioni i tarifave është përcaktua për rekrutim të një punëtori të ri për këtë seksion, nga numri i përgjithshëm prej tre vete.</p>	

## 9. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin shtator 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
9.1.	Procesi tarifor për KRU-ët për vitin 2007/08.	ZRRUM-i përfundimisht gjatë këtij muaj ka rrumbullakosua gjithë procesin tariforë dhe ka mënjanua të gjitha dilemat për tarifat e reja. Prandaj, ka përpilua dhe dërgua RPV-ët dhe ka pritë komentet përfundimtare të kompanive. Si rezultat final ZRRUM-i ka përgatit dhe lëshua Urdhëresat Tarifore të Shërbimeve për të gjitha kompanitë të cilat i ka licencua për ofrim të këtyre shërbimeve.	Sami Hasani dhe Ymer Fejzullahu
9.2	Bashkëpunimi me konsulentin e UNDP-ës.	Përcaktimi i tarifës së ujit me shumicë për URM-ën ka mbet angazhim kryesorë i këtij konsultanti i cili ka marrë pjesë në takimet tona të përbashkëta.	
9.3	Bashkëpunimi me konsulentet e IPA-së.	Me konsulentet e IPA-së kemi diskutua çështjen e implementimit dhe mënyrën e realizimit të Kontabilitetit të Rregullatorit nëpër KRU-të.	
9.4	Përcaktimi i tarifës së ujit me shumicë të UR Mitrovica, Mitrovicë	URM-ja ka bërë aplikimin zyrtarë për tarifa shërbimi të ujit me shumicë. Për këtë ZRRUM-i ka dhënë vërejtjet e veta të para me të cilat e ka njoftua kompaninë dhe ka mbajt kontakte të rregullta për sqarim dhe plotësim të dhënave.	

## 10. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin tetor 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
10.1.	Procesi tarifor për KRM-ët për vitin 2007/08.	<p>Seksioni i Tarifave ka vazhdua kontaktet për përshpejtimin e procesit të përfundimit të tarifave për KRM-ët.</p> <p>Gjatë këtij muaj janë organizua takime me të gjithë përfaqësuesit e kompanive veç e veç dhe për herë të fundit janë dhënë sugjerimet dhe janë marrë komentet e tyre me qëllim finalizim të kësaj pune.</p> <p>Ky seksion përveç analizimit të dhënave dhe komenteve të marra nga kompanitë ka përgatit versionin e shkurtuar të Raporteve Përfundimtare të Vlerësimit (RPV) me të cilat i ka njoftua KRM-ët që kanë pas një dokumentacion ma të kompletuar dhe pas kësaj faze janë përgatitë draftet e RPV-ve dhe janë dërgua te gjitha kompanive.</p>	Sami Hasani dhe Ymer Fejzullahu
10.2	Bashkëpunimi me konsulentin e IPA-së.	<p>Inicimi i përgatitjeve për punëtorinë që duhet mbajt për procedurat e politikave të e reja tarifore në sektorin e ujit me pakicë dhe shumicë.</p> <p>Këtu është diskutua edhe kontabiliteti i rregullatorit dhe mënyra dhe metodologjia e përcaktimit të Vlerës Rregullatore të Aseteve (VRRRA).</p>	
10.3	Përcaktimi i tarifës së ujit me shumicë për URM-ën.	<p>Përcaktimi i tarifës së ujit me shumicë për URM-ën ka mbet angazhim kryesorë i sektorit edhe për këtë muaj, për çka janë mbajt disa takime radhazi me përfaqësuesit e URM-së.</p>	
10.4	Përgatitja për punëtorinë e planifikuar për muaj dhjetor 2007	<p>Në vazhdën e angazhimeve me konsulentet, kemi filluar përgatitjet e nevojshme për mbajtjen e punëtorisë së planifikuar për dhjetor 2007, ku do të shqyrtohen politikat dhe sistemi i rij eventual i tarifave gjatë vitit 2008/11.</p>	

## 11. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin nëntor 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
11.1	Procesi tarifor për KRM-ët për vitin 2007/08.	<p>ZRRUM-i ka lëshua të gjitha Urdhëresat Tarifore të Shërbimit (UTSH) për të gjitha kompanitë e mbeturinave të cilat i ka licencua për këtë shërbim.</p> <p>Nga UTSH-ët e lëshuar seksioni i Tarifave në ZRRUM nuk ka marr ndonjë vërejtje në përmbajtjen e tyre dhe procesin e zhvilluar, me përjashtim të KRM "Uniteti" Mitrovicë e cila ka kërkuar përkufizimin më të saktë të rigrupimit dhe rikategorizimit të konsumatorëve të shërbyer.</p> <p>Kjo kërkesë e kompanisë është vlerësua si e arsyeshme pas rishikimit të dhënave të ofruara nga kjo kompani.</p>	
11.2	Bashkëpunimi me konsulentin e IPA-së.	<p>Përcaktimi i 12 dhjetorit 2007 si datë kur do të mbahet Punëtori ka kërkuar angazhim shtesë në të cilën Seksioni i Tarifave do të ketë një prezantim për vijueshmërinë e procesit tariforë për shërbimet e ujit.</p>	<p>Sami Hasani dhe Ymer Fejzullahu</p>
11.3	Përcaktimi i tarifës së ujit me shumicë për URM-ën.	<p>Angazhim i radhës në Sektorin e Tarifave ka mbetë rrumbullakimi i procesit të përcaktimit të tarifave për shërbimit furnizim me ujë me shumicë nga URM-ja për Veriun e Mitrovicës.</p> <p>Në vazhden e punëve për këtë qëllim janë mbajtur takimet e radhës ku jemi munduar me i sqaruar pakjartësitë e qfaqura.</p>	
11.4	Rregullimi dhe fajllimi i dokumentacionit të mbledhur me rastin e përcaktimit të tarifave të shërbimit për ujë për vitin 2007/08.	<p>Ky seksion është angazhuar në selektimin, rregullimin dhe fajllimin e dokumentacionit të cilin e ka mbledhur gjatë punës së vetë për përcaktim të tarifave të këtij viti.</p>	

## 12. Aktivitetet e punës së Seksionit të Financave dhe Tarifave për muajin dhjetor 2007

Numri Rend.	Përmbledhja e punëve	Përshkrimi i punëve të kryera	Stafi i angazhuar
12.1.	Rregullimi dhe fajllimi i dokumentacionit të mbledhur me rastin e përcaktimit të tarifave të ujit për vitin 2007/08.	Ka vazhdua puna në selektimin, rregullimin dhe fajllimin e dokumentacionit të cilin e ka mbledhur gjatë punës së vetë për përcaktim të tarifave të këtij viti dhe vitit pasues.	Sami Hasani dhe Ymer Fejzullahu
12.2	Përcaktimi i tarifës së ujit me shumicë për URM-ën.	Seksioni i Tarifave ka definua të gjitha çështjet e hapura dhe ka ardhë në përfundim për të përcaktua tarifat e ujit me shumicë për URM-ën për vitin 2008. Për këtë qëllim është përgatit versioni i parë i Raportit Përfundimatrë të Vlerësimit me të cilin do të njoftohet kompania në fillim të vitit të rij 2008.	
12.3	Punëtorja për politikat dhe procesin e ardhshëm tariforë.	Në organizim të firmës konsulente IPA kemi përgatit dhe kemi qenë prezentuas në këtë punëtori me temën "Përvojat e Fituar Gjatë Procesit Tariforë për Shërbimet e Ujit Gatë Vitit 2007".	
12.4	Rregullimi dhe fajllimi i dokumentacionit të mbledhur me rastin e përcaktimit të tarifave të shërbimit për ujë për vitin 2007/08.	Ky seksion është angazhua në selektimin, rregullimin dhe fajllimin e dokumentacionit të cilin e ka mbledhur gjatë punës së vetë për përcaktim të tarifave të këtij viti dhe vitit pasues. Kjo punë do të vazhdojë edhe gjatë janarit të vitit 2008.	

Prishtinë, 15 janar 2008

Sami Hasani, Udhëheqës për Financa dhe Tarifa në ZRRUM